



UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”  
FAKULTETI FILOZOFIK  
DEPARTAMENTI I HISTORISË

Mr.sc. ISMIJE BESHIRI

**ÇËSHTJA SHQIPTARE NË VITIN 1912 SIPAS BURIMEVE  
DIPLOMATIKE GJERMANE**

PUNIM I DOKTORATËS

Prishtinë, 2018



UNIVERSITY OF PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”  
FACULTY OF PHILOSOPHY  
DEPARTMENT OF HISTORY

Mr.sc. ISMIJE BESHIRI

**ALBANIAN QUESTION IN 1912 ACCORDING TO GERMAN  
DIPLOMATIC RECORDS**

PhD Theses

Prishtina, 2018



UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”  
FAKULTETI FILOZOFIK  
DEPARTAMENTI I HISTORISË

Mr.sc. ISMIJE BESHIRI

**ÇËSHITJA SHQIPTARE NË VITIN 1912 SIPAS BURIMEVE  
DIPLOMATIKE GJERMANE**

**PUNIM I DOKTORATËS**

Mentor:  
Prof. Dr. Gazmend Rizaj

Komisioni:

1. Prof. Dr. Ibrahim Gashi
2. Prof. Asoc. Dr. Nuri Bexheti
3. Prof. Dr. Liman Rushiti

Prishtinë, 2018

## Pasqyra e lëndës

Falënderim.....	5
Abstrakti.....	6
Abstract.....	7
PARATHËNIE.....	10
KAPITULLI I.....	22
Fuqitë e Mëdha dhe Ballkani në fillim të shekullit XX.....	22
I.1. Perandoria Osmane në fillim të shekullit XX.....	22
I.2. Politikat ballkanike të Fuqive të Mëdha.....	25
I.3. Synimet ekspansioniste të monarkive të reja ballkanike.....	27
KAPITULLI II.....	31
Qëndrimi i diplomacisë gjermane ndaj kryengritjeve shqiptare të viteve 1910-1912.....	31
II. 1. Kryengritja shqiptare e Kosovës e vitit 1910.....	31
II.2. Kryengritja shqiptare e Malësisë së Mbishkodrës e vitit 1911.....	52
II.3. Kryengritja shqiptare e vitit 1912 në vigjilje të pavarësisë së Shqipërisë.....	97
II.4. Disa njoftime të diplomacisë gjermane mbi rrethanat politike në Shqipëri pas përfundimit të kryengritjes së vitit 1912.....	115
KAPITULLI III.....	118
Burimet gjermane mbi çështjen e Shqipërisë në prag dhe gjatë luftërave ballkanike.....	118
III.1. Diskutimet e Aleancës Trepalëshe mbi organizimin e shtetit të ardhshëm shqiptar dhe synimet serbe mbi Adriatikun shqiptar.....	118
III.2. Qëndrimi i Gjermanisë për pavarësinë e Shqipërisë.....	123
III.3. Sekuenca nga shtypi gjerman i kohës për pavarësinë e Shqipërisë.....	128
III.4. Organizimi i Konferencës së Ambasadorëve në Londër dhe kontributi diplomatik i Gjermanisë për organizimin e saj.....	133
III.5. Konferenca e Triestes.....	140
PËRMBYLLJE.....	143

Shtojcë – Anex.....	147
a. Dokumente diplomatike gjermane.....	147
Shtojca Nr. 1.....	147
Shtojca Nr. 2.....	148
Shtojca Nr. 3.....	151
Shtojca Nr. 4.....	153
Shtojca Nr. 5.....	153
Shtojca Nr. 6.....	157
Shtojca Nr. 7.....	159
Shtojca Nr. 8.....	160
Shtojca Nr. 9.....	160
Shtojca Nr. 10.....	162
Shtojca Nr. 11.....	163
Shtojca Nr. 12.....	163
Shtojca Nr. 13.....	166
BURIMET DHE LITERATURA.....	171
BURIMET E PAPUBLIKUARA.....	171
BURIMET E PUBLIKUARA.....	174
LITERATURA E SHFRYTËZUAR.....	175
LITERATURA E KONSULTUAR.....	177
JETËSHKRIMI I KANDIDATES.....	181
JETËSHKRIMI I MENTORIT.....	183

## Vështrim konciz mbi disertacionin e doktorates

Gjatë skicimit të parathënies, duke iu përmbajtur parimeve themelore të metodologjisë së punës shkencore, gjetën vend këto elemente:

**Synimet** - Me këtë hulumtim synoj ta nxjerr në pah qëndrimin e Perandorisë Gjermane (Deutsche Kaiserreich) lidhur me kryengritjet shqiptare në prag të pavarësisë së Shqipërisë. Pjesa më e madhe e hulumtimit shkencor është bërë në Arkivin e Ministrisë së Jashtme të Gjermanisë, por njëhohësisht, për hire të krahasimit, janë zhvilluar edhe hulumtime në Arkivin Politik të Ministrisë së Jashtme të Austrisë. Këto arkiva e kanë mundësuar studimin dhe krahasimin e raporteve të ambasadave dhe konsullatave gjermane dhe austro-hungareze në Stamboll dhe në kryeqytete të tjera, si në: Athinë, Sofje, Bukuresht, Budapest, Beograd, Vjenë, Cetinë, Shkup, Manastir, Shkodër, Prizren, Mitrovicë, Vlorë, Janinë etj. Po ashtu, kam pasur parasysh t’i nxjerr në pah politikat gjermane lidhur me pavarësinë e Shqipërisë dhe t’i shtjelloj me syrin kritik këto politika, pasi në historiografinë shqiptare deri më tani, kur është folur për studimin e dokumenteve gjermane, kryesisht janë trajtuar dokumente nga arkivat austriake e jo nga ato gjermane.

Ideja e historiografisë shqiptare për Gjermaninë deri më tani bazohet kryesisht në thënien e Bismarkut gjatë Kongresit të Berlinit më 1878 që, sipas historisë shqiptare, ka thënë se: “Shqipëria është vetëm një shprehje gjeografike dhe asgjë më shumë”. Në këtë thënie është bazuar e gjithë historia shqiptare në lidhje me qëndrimin e Gjermanisë ndaj pavarësisë së Shqipërisë. Po ashtu, është kaluar nga premisa që Gjermania nuk ka pasur interesa të drejtpërdrejta në Shqipëri, por i ka përkrahur vetëm aleatët në aleancën trepalëshe, Austro-Hungarinë dhe Italinë në lidhje me Shqipërinë.

Siç tregojnë dokumentet e studiuara gjatë këtij punimi, në të gjithë Ballkanin, Gjermania ka përkrahur në radhë të parë Austro-Hungarinë, por ka mbrojtur edhe interesat e saj në Ballkan dhe më gjerë, pasi edhe interesat gjermane në Ballkan kanë qenë të lidhura ngushtë me politikat e Austro-Hungarisë, pavarësisht prej Ruisë, antantës trepalëshe dhe pansllavizmit në përgjithësi, i cili synonte zgjerimin e vet drejt territoreve shqiptare dhe dalje në Adriatik. Siç tregojnë dokumentet e studiuara, Perandoria Gjermane ishte shumë mirë e informuar mbi ndodhitë në Shqipëri, për kryengritjet shqiptare dhe për gjendjen në përgjithësi.

Ambasadori i Gjermanisë në Perandorinë Osmane, ashtu siç thoshte edhe Von Buelov në librin e vet, për të satën herë ia kishin tërhequr vërejtjen Portës së Lartë të sillej më butë në Shqipëri dhe me shqiptarët, pasi Gjermania e kishte të qartë se nëpërmes konsolidimit dhe fuqizimit të Perandorisë Osmane në pjesën evropiane, po i vihej fre pansllavizmit dhe zgjerimit territorial të Serbisë në pjesën evropiane të Perandorisë Osmane, pikërisht në territoret shqiptare.

### **Çështjet e trajtuara në hulumtimet e mëhershme dhe problemet e pashtjelluara që lidhen me temën dhe hulumtimin tim**

- Ka pasur publikime të mëhershme nga prof. Arben Puto në të cilat shprehet interesim për studimin dhe publikimin e dokumenteve kryesisht angleze (të Foreign Office), aty-këtu edhe të ndonjë dokumenti të proveniencës austro-hungareze dhe ruse. Edhe prof. dr. Gazmend Rizaj është marrë me studimet e dokumenteve angleze dhe italiane. Në Shqipëri është bërë edhe një botim dhe ka pasur studime dhe publikime të dokumenteve austro-hungareze në vëllime të tëra. Prof. dr. Romeo Gurakuqi ka publikuar, po ashtu, dokumente austro-hungareze dhe italiane. Por, kur është folur për dokumente gjermane, kryesisht është menduar për ato austro-hungareze. Në fakt, edhe pse e kanë pasur këtë mendje dhe i kanë konsideruar të njëllorja, dokumentet gjermane janë fare të pa përfshira dhe të studiuara deri më tash nga studiuesit e historisë dhe të diplomacisë gjermane për Shqipërinë dhe shqiptarët.

**Shfrytëzimi i bazës burimore** - Fondi i materialeve në Ministrinë e Jashtme të Gjermanisë është shumë i pasur. Aty janë ruajtur të gjitha raportet e ambasadave dhe të konsullatave gjermane. Fondi i Shqipërisë deri në vitin 1914 është i përmbledhur nën Fondin e Perandorisë Osmane. Pas 1914-s fondi është i kataloguar nën emrin e Shqipërisë.

Arkivi Politik i Ministrisë së Punëve të Jashtme në Berlin përmban fonde të shumta dokumentesh - raporte të ambasadorëve dhe të konsujve gjermanë të akredituar në qendra të shumta perëndimore dhe ballkanike, si në: Petersburg, Vjenë, Romë, Trieste, Stamboll, Selanik, Shkup, Beograd, Cetinë etj.

Hulumtimi dhe trajtimi i dokumenteve të proveniencës diplomatike gjermane për vitin 1912 përgjithësisht ishte lënë pas dore nga studiuesit shqiptarë, pasi ekzistonte një bindje e gabuar, se Gjermania atëbotë politikat ballkanike ia kishte lënë në dorë aleates së saj, Austro-Hungarisë, duke qenë se Gadishulli Ballkanik nuk ishte në sferën e interesit të veçantë gjerman. Mbase për

këtë shkak hulumtuesit shqiptarë janë marrë kryesisht me arkivat dhe dokumentet austro-hungareze, duke i neglizhuar pothuajse ato të Rajhut gjerman.

Ambasadorët dhe konsujt gjermanë në vendet e lartpërmendura kanë shkruar raporte për gjendjen në Shqipëri, duke u bazuar edhe në informacionet që i merrnin nga ministritë përkatëse të vendeve nga raportonin. Përveç konsullit të Cetinës, i cili ishte shumë afër ngjarjeve reale dhe kishte lidhje të drejtpërdrejta me malësorët shqiptarë të veriut, edhe të tjerët kontaktonin herë pas here me shqiptarë të rangjeve dhe të rrymave të ndryshme për të cilët shkruanin raporte të hollësishme dhe jepnin mendimet dhe pikëpamjet e tyre mbi Shqipërinë dhe shqiptarët.

Ambasadorët gjermanë, po ashtu, raportonin në Berlin lidhur me opinionet e diplomacisë së fuqive të tjera mbi çështjen shqiptare. Për këtë arsye, bibliografia e Ministrisë së Jashtme gjermane, "Auswaertiges Amt, Politisches Archiv Findbuch, Auswaertiges Amt 1867-1820, Oxford, Teil I", shumicën e materialeve mbi Shqipërinë për këtë periudhë i ka të klasifikuara në fondin "Stambolli", duke qenë se ambasadori gjerman në Stamboll ishte përgjegjës edhe për çështjet e Shqipërisë. Vetëm pas vitit 1914 materialet mbi Shqipërinë radhiten me emërtimin e Shqipërisë, kur Gjermania fillimisht dërgoi emisarët e vet në Shqipëri, një herë si pjesëtarë të Komisionit për Caktimin e Kufijve të Shqipërisë, më vonë kur emëron ambasadorin e vet në Shqipëri.

Burimet diplomatike gjermane që janë shfrytëzuar në këtë punim na japin idenë se shteti gjerman, si një nga gjashtë Fuqitë e Mëdha të kohës, jo vetëm se nuk kishte qëndrim negativ ndaj çështjes shqiptare në përgjithësi, sikur është tentuar të përshkruhet nga disa historianë të ndryshëm shqiptarë të kohës së diktaturës komuniste, por ishte pozitiv dhe përkrahës konsekuent për krijimin e shtetit të Shqipërisë.

Interes të veçantë në këtë punim do të zënë edhe politikat evropiane të Gjermanisë, sidomos ato mbi Ballkanin si dhe interesat dhe aleancat gjermane. Po ashtu, do t'i hidhet edhe një vështrim politikës së Gjermanisë ndaj Perandorisë Osmane dhe si e kanë influencuar këto politika dhe interesa qëndrimin e Gjermanisë ndaj Shqipërisë. Njëkohësisht, do të merren parasysh edhe hulumtimet e autorëve gjermanë të kohës, si Marie Amelie Freiin von Godin, e cila, në ditën e shpalljes së pavarësisë, ka qenë në Vlorë, por edhe raporte të shtypit gjerman të kohës. Do të merren në konsideratë edhe rezultatet shkencore të historianëve gjermanë të ditëve të vona, si të prof. dr. Stadmuhlere dhe të prof. dr. Bartl, edhe ato pak publikime të autorëve shqiptarë mbi këtë periudhë mbështetur në dokumente gjermane.



**Çështjet që trajtohen në secilin kapitull veç e veç dhe metodat e përdorura** - Në kapitullin e parë trajtohet gjendja e Perandorisë Osmane në fillim të shekullit XX dhe qëndrimi i Gjermanisë në lidhje me situatën në Perandorinë Osmane. Kuptojmë se në këtë etapë gjendja e perandorisë ishte shumë e tendosur. Perandoria Osmane ishte në perëndimin e saj dhe shkonte me shpejtësi drejt ndryshimeve të mëdha. Formimi i partisë Bashkim dhe Përparim, rrëzimi i Sulltanit të gjithëfuqishëm nga xhonturqit dhe ndërrimi i sistemit qeverisës, shpion në një rend të ri gjithë Evropën Lindore dhe Ballkanin. Aneksimi i Bosnjës dhe Hercegovinës, deklarimi i pavarësisë së plotë të Bullgarisë nga Sulltani dhe bashkimi i Kretës me Greqinë ishin vetëm copëzat e para që vetëm katër vjet më vonë çuan në shpërbërjen e plotë të perandorisë në Evropë dhe krijimin e një rendi të ri në Ballkan. Xhonturqit, të cilët kishin për qëllim bashkimin e perandorisë, me politikën e tyre të rrepta çuan në shpërbërjen totale të saj. Rënia e Sulltan Abdyl Hamitit ishte një ndryshim rrënjësor. Pasi u proklamua Kushtetuta pas 30 vjetësh, u lejua shtypi i lirë dhe filloi botimi i një sërë revistash dhe gazetash si dhe shprehja e mendimit të lirë. Por, xhonturqit kishin diçka tjetër në mendje; të influencuar nga jakobizmi në Gjermani, donin të krijonin një shtet unitar turk në gjithë perandorinë. Popujt e ndryshëm që pritnin atëbotë një lloj autonomie më të gjerë u mbështetën për muri sepse nga ta kërkohej të ishin më shumë osmanë sesa shqiptarë, kurdë, armenë ose arabë. Kjo kërkesë çoi në kryengritje të mëdha, sidomos tek shqiptarët. Këto kryengritje nuk u ndalen derisa filloi Lufta e Parë Ballkanike. Po ashtu, situata ekonomike e perandorisë ishte shumë e tendosur. Perandoria Osmane ishte zhytur në borxhe tek bankat franceze dhe kapitali anglez. Në fillim të shekullit edhe Gjermania filloi të depërtojë në treg dhe mori koncesionin për ndërtimin e hekurudhës së Bagdadit dhe hekurudhave lokale, që rezultoi në pakënaqësi të mëdha të Francës dhe të Anglisë.

Depërtimi i Gjermanisë në këtë treg përbënte, për Perandorinë Osmane, një garanci nga një perandori që nuk kishte interesa të shtrirjes territoriale në territoret e saj dhe një mbrojtje nga Rusia, Anglia dhe Franca që kishin synime të drejtpërdrejta territoriale. Por, kishte edhe një risi të veçantë, pasi Gjermania nuk mori në koncesion vetëm ndërtimin e hekurudhës, por edhe shfrytëzimin dhe ndërtimin e të gjithë infrastrukturës dhe projekteve ekonomike deri te të drejtat e shfrytëzimit të minierave dhe zbulimeve arkeologjike përgjatë trastës së hekurudhës. Kjo s'ishte praktikuar ndonjëherë më parë, prandaj tri fuqitë e Antantës Trepalëshe, Anglia, Franca dhe Rusia, shprehën shqetësim dhe pakënaqësi.

Në politikat ballkanike të Fuqive të Mëdha, trajtohen politikat e dy blloqeve të fuqive rreth ndryshimeve të mëdha në Ballkan, si në rrafshin politik ashtu edhe ekonomik. Aleanca Trepalëshe, në krye me Gjermaninë, përveç interesave ekonomike, kishte për qëllim edhe frenimin e pansllavizmit dhe depërtimin e tij drejt Perëndimit dhe daljes në Adriatik të Serbisë dhe, “de facto”, zgjerimin e Ruisë drejt Perëndimit. Antanta Trepalëshe, në krye me Rusinë, e përkrahte daljen e Serbisë në Detin Adriatik si dhe daljen e Ruisë dhe Anglisë në ngushticat e Dardaneleve dhe zgjerimin e tri fuqive ballkanike, Serbisë, Bullgarisë dhe Greqisë, në territoret shqiptare që shiheshin si sferë e interesit të Austro-Hungarisë dhe të Italisë.

Edhe planet e hekurudhave përbënin një pikë konflikti mes fuqive ballkanike dhe Fuqive të Mëdha. Ashtu sikurse Fuqitë e Mëdha, edhe monarkitë e reja ballkanike planifikonin me kujdes shtrirjen e tyre përreth. Këtë donin ta bënin në vigjilje të luftërave ballkanike me zgjerimin e interesave të tyre ekonomike dhe planeve infrastrukturore. Vlen të përmendet këtu lufta doganore e njohur si “Lufta e derrave”, e cila plasi më 1906-1908 në mes të Austro-Hungarisë dhe Serbisë. Pikërisht në këtë kohë Serbia me këmbëngulje po shtynte gjithandej synimin për ndërtimin e një hekurudhe shumë të kushtueshme dhe të pasigurt që do të kalonte përmes territoreve shqiptare për të dalë në Durrës, ndërkaq Austro-Hungaria si kundërpropozim, e shtynte projektin për ndërtimin e hekurudhës së Novi Pazarit që do ta lidhte Sarajevën me Selanikun. Austro-Hungaria, me ndihmën e Gjermanisë, e cila veç gëzonte influencë të madhe në Stamboll, arriti ta nxjerrë koncesionin për këtë hekurudhë. Këto hekurudha çonin drejt synimit të zgjerimit në tokat veriore shqiptare duke e lënë të izoluar Malin e Zi. Edhe Italia kishte planet e veta për një hekurudhë në Shqipëri që do të niste nga Vlora apo Durrësi për në Manastir dhe Selanik në rrugën e lashtë Via Egnatia. Vlen të theksohet se as plani i hekurudhës Danub-Adriatik, as planet e tjera hekurudhore nuk u realizuan sepse fillimi i realizimit të kësaj hekurudhe përkoi me fillimin e luftërave ballkanike dhe kundërshtimin e ashpër të shqiptarëve të Kosovës që e kishin të qartë se nuk bëhej fjalë vetëm për plane infrastrukturore, por për zgjerim territorial në tokat e tyre.

Lidhur me krizën ballkanike të vitit 1912, do të shqyrtohet fillimi i krizës në Ballkan më 1908 si dhe rirreshtimi i Fuqive të Mëdha. Austria nxitoi ta aneksonte Bosnjën dhe ngjalli frikë e dyshime jo vetëm te fuqitë e Antantës, por edhe tek Italia. Ajo, e shtyrë edhe nga gjendja ekonomike dhe nga ndjenja se kishte mbetur prapa Anglisë dhe Francës në kolonizimin e Afrikës, pushtoi Libinë në tetor të vitit 1911.

Në kapitullin e dytë do të trajtohet qëndrimi i diplomacisë gjermane ndaj kryengritjeve shqiptare të vitit 1910-1912 që u zhvilluan në prag të Luftës së Parë Ballkanike dhe që çuan në pavarësinë e Shqipërisë. Në pjesën e parë të këtij kapitulli elaborohet kryengritja e vitit 1910, në kontekstin e ardhjes në pushtet të Turqve të Rinj, të cilët me forcë propagandonin për një shtet centralist. Kryengritjet e shumta shqiptare, sidomos në Shqipërinë Veriore dhe të Mesme, në vilajetet e atëhershme të Kosovës dhe Manastirit, e detyruan Perandorinë Osmane të ndërhynte me trupa të shumta dhe disa herë radhazi. Ky rebelizëm drejtohej kundër modernizmit neo-osman, taksave të reja, shërbimit të detyruar ushtarak, regjistrimit të popullsisë, gjuhës osmane, alfabetit arab etj.

Kryengritja e parë filloi në shkurt të vitit 1910 dhe u përhap në tërë Kosovën. Gjendja e acaruar mori përmasa të papritura kur në prill të atij viti, sipas atashut ushtarak të Gjermanisë në Stamboll, u vra mytesarifin dhe një major turk në Pejë. Atëherë Porta e Lartë filloi dislokimin e trupave në Shkup dhe në vilajetin e Kosovës. Gjermania me shumë interes e ndiqte çështjen nga afër. Diplomatat gjermanë të akredituar në Austri dhe në vendet fqinje me Shqipërinë raportonin rregullisht për gjendjen në Shqipëri, ashtu si edhe atashu ushtarak në Stamboll.

Kryengritja e parë filloi në Prishtinë. Situata në Shqipëri ishte shumë e tensionuar dhe Austro-Hungaria bashkë me Gjermaninë po ia tërhiqnin vërejtjen Perandorisë Osmane të sillej më butë me shqiptarët, pasi që një sjellje jo e mirë ndaj tyre dhe vazhdimi i kryengritjes shkonte në dëm të tyre dhe në favor të Rusisë dhe Serbisë. Shkohej deri aty sa të mendohej se Rusia mund të ishte pas këtyre kryengritjeve. Por, me ecjen e kohës dhe me marrjen hov të kryengritjes, Austro-Hungaria ndryshoi qëndrim ndaj kryengritjes. Diplomatat gjermanë besonin se një ndër nxitësit e kësaj kryengritje dhe që kishte shtuar mosbesimin dhe mllëfin ndaj Perandorisë Osmane ishte edhe vizita e mbretit të Serbisë në prill të vitit 1910 në Stamboll. Kjo i bënte shqiptarët të dyshojnë se Perandoria Osmane dhe Serbia po bënin marrëveshje të fshehta kundër shqiptarëve. Bazuar në qarqe mirë të informuara nga Stambolli, Konsullata Gjermane në Selanik lajmëronte se në Stamboll, akuzoheshin si udhëheqës të kryengritjes, Ismail Qemali, Ferid Pasha, Nexhip Bej Draga, Bajram Curri dhe Hasan Bej Prishtina dhe për të njëjtit kërkoheshin dënimi për rebelim. Në të njëjtën kohë, grekët dhe sllavët, të shqetësuar se mos shqiptarët do ta marrin përkrahjen e Austro-Hungarisë, fillojnë të përhapin dezinformata mbi kryengritjen shqiptare nëpërmes diplomatëve të tyre dhe shtypit të kohës, i cili nga Gjermania ndiqet me përpikëri dhe raportohet në Berlin. Po ashtu, në këtë kapitull trajtohet çështja e ndihmave nga jashtë, sidomos nga Italia

që i arritën kryengritësve shqiptarë në armatim dhe financa, si dhe përfundimi i kësaj kryengritje që kishte si pasojë mijëra refugjatë shqiptarë nga Kosova dhe Malësia e Shkodrës për në Mal të Zi, me ç'rast doli në pah roli dhe qëndrimi i Malit të Zi ndaj kryengritjes shqiptare.

Në vijim trajtohet kryengritja e vitit 1911. Kryengritja e vitit 1910 i kishte organizuar shqiptarët anembanë dhe shoqata të ndryshme filluan të aktivizohen. Në shkurt të vitit 1911 kryengritjet e para filluan në Dibër, për të pasuar në Mat dhe në Mbishkodër. Po ashtu, ishte e qartë se shqiptarët e ikur në Mal të Zi prisnin vetëm të vijë pranvera për të filluar një kryengritje të re. Në Ministrinë e Jashtme të Gjermanisë, në fillim të shkurtit, lajmërohej se situata në Shkup është shumë e ndjeshme. Me këtë rast trajtohet edhe tensionimi i konfliktit mes Italisë dhe Perandorisë Osmane, i cili kulmoi me pushtimin e Tripolit dhe Bengazit. Në Serbi vërehet përshkallëzimi i kritikave ndaj Austro-Hungarisë dhe “dëgjoheshin” kambanat që paralajmëronin luftë. Kryengritja shqiptare fillon në mars 1911 dhe gjithandej lajmërohet për përparime dhe për marrjen e Tuzit nga kryengritësit shqiptarë. Mali i Zi, i shqetësuar nga e gjithë kjo situatë dhe nga armatimi i popullatës myslimane nga ana e turqve, u drejtohet me një memorandum Fuqive të Mëdha që të ndërhyjnë tek Perandoria Osmane për ta parandaluar konfliktin. Në fund të prillit edhe shqiptarët iu drejtuan me një memorandum Fuqive të Mëdha, që është i njohur si Libri i Kuq ose Memorandumi i Greçës. Në maj të 1911-s në Cetinë vjen për vizitë Luigj Gurakuqi dhe pasojnë edhe vizita të personaliteteve të tjera si nga Ismail Qemali etj.

Situata gjatë 1911-s ishte shumë e tensionuar edhe mes Fuqive të Mëdha. Pa dyshim se çështja shqiptare ishte një ndër pikat e rëndësishme. Në një bisedë midis ambasadorit të Rusisë dhe kontit Aerhental, ministri i Jashtëm i Austro-Hungarisë i thotë atij: “Në qoftë se dëshirojmë vërtet paqe, duhet t’i lëmë popujt e Ballkanit të digjen në zjarrin që e ndezin vetë”. Por, këtu do të shohim se politika e jashtme e Austro-Hungarisë në verën e vitit 1911 fillon të kritikohet ashpër nga shtypi dhe publiku austriak, pasi Austro-Hungaria po i neglizhonte detyrimet e saj sipas kultusprotektoratit që i kishte ndaj katolikëve shqiptarë dhe shqiptarëve në përgjithësi.

Vizita e Sulltanit në Maqedoni dhe Kosovë është, po ashtu, një episod i rëndësishëm më 1911. Sulltani nëpërmes Selanikut viziton edhe Fushë-Kosovën, ku ishin të varrosura eshtrat e stërgjyshit të tij, Sulltan Muratit I. Shpresat ishin se Sulltan Mehmeti V do të njoftohej nga afër me problemet e rajonit dhe varfërinë që sundonte këtu. Sipas informatave gjermane, Sulltani kishte me vete 10 000 funte që do t’i shpërndante gjatë qëndrimit të tij në Maqedoni dhe Kosovë për t’i ndihmuar refugjatët shqiptarë në Mal të Zi. Është për t’u theksuar se gjatë vitit 1911

shqiptarët marrin ndihma në armatime nga të gjitha anët. Pra, përderisa më 1910 xhonturqit çarmatosën me dhunë popullatën shqiptare, më 1911 shqiptarët po merrnin armë nga të gjitha anët. Por, kishte edhe informata se Porta e Lartë po e armatoste popullatën myslimane në Shkodër dhe Kosovë.

Gjatë gjithë vitit Mali i Zi dhe mbreti Nikolla vazhdonin të luftonin për një rol më të avancuar të Malit të Zi në kurriz të kryengritjes shqiptare. Mbreti Nikolla herë paraqitej si përkrahës i malësorëve dhe çështjes shqiptare, herë si ndërmjetësues, herë si viktimë e ngjarjeve. Ai me çdo kusht përpiqej ta nxirrte në pah rolin e rëndësishëm që kishte Mali i Zi në rajon. Qëllimi kryesor i tij ishte përfitimi financiar nga të gjitha anët: edhe nga Rusia, edhe nga Austro-Hungaria apo Italia. Në këtë treshe të interesit malazez, të vetmit që e kuptojnë më së miri lojën e Malit të Zi janë austro-hungarezët, të cilët e kanë të qartë se mbreti Nikolla ka vetëm një synim: zgjerimin e territorit malazez në kurriz të tokave shqiptare.

Ambasadorët e Gjermanisë dhe të Austro-Hungarisë në Stamboll gjatë tërë kohës ishin shumë aktivë dhe përsërisnin presionin tek Porta e Lartë për të bërë një marrëveshje me shqiptarët për trajtim më të mirë të tyre. Ky presion bëhej sidomos nga ambasadori i Austro-Hungarisë, konti Pallavicini, i cili nuk pushonte së takuari ministra të Qeverisë së Perandorisë Osmane për të ndërhyrë në dobi të shqiptarëve.

Në këtë kapitull, po ashtu, i bëhet një vështrim çështjes shqiptare, gjithmonë nga këndvështrimi i diplomatëve gjermanë në rajone. Shqyrtohet po ashtu edhe fakti se si shikohej kryengritja e shqiptarëve jo vetëm në Cetinë, por edhe në Bukuresht, Sofje, Beograd, Budapest etj. Në fund të gushtit kryengritja e shqiptarëve mbaron me një marrëveshje dhe me fundin e kryengritjes së shqiptarëve. Në prag të Luftës së Parë Ballkanike edhe raportet për Shqipërinë dhe shqiptarët rrallohen. Më 31 gusht përfaqësuesi gjerman lajmëron nga Stambolli se gjatë vizitës së tij në Shqipëri, atashu ushtarak turk Enver Beu, i intervistuar nga një gazetë italiane, kishte deklaruar se problemet me malësorët ishin rezultat i intrigave austro-hungareze.

Me afrimin e fillimit të Luftës së Parë Ballkanike shqiptarët ishin nën dilemën se çfarë qëndrimi të mbanin. Nga Stambolli përfaqësuesit e Gjermanisë njoftonin për mundësinë që shqiptarët të luftonin përkrah Perandorisë Osmane në qoftë se do të sulmoheshin tokat e tyre. Në këtë kapitull vend qendror i kushtohet Kryengritjes së vitit 1912. Në fakt, fillimi i luftës italo-osmane për Tripolin e kishte komplikuar çështjen shqiptare edhe më shumë. Më 7 janar 1912 ambasadori gjerman në Kostandinopojë lajmëronte, ndër të tjera mbi seriozitetin e situatës në Shqipëri si

pasojë e qëndrimit irracional të turqve. Në raportimet e diplomatëve gjermanë nënvizohej se shqiptarët nuk kishin kërkesa të tepruara, përpos ndërtimit të rrugëve, lejimit të alfabetit latin për shkrimin e gjuhës shqipe, ruajtjes së privilegjeve të vjetra dhe të posaçme në lidhje me kryerjen e ushtrisë dhe të tatimeve. Diplomatët gjermanë më se një herë i kishin paralajmëruar krerët e shtetit osman që ta gjenin një kompromis të menjëhershëm me shqiptarët, rreziku i shpërthimit të zjarrit në Ballkan ishte shumë më i madh se më herët.

Në këtë kapitull trajtohet hollësisht fillimi i kryengritjes së vitit 1912 dhe ndarja e shqiptarëve në tre grupe. Sipas dokumenteve gjermane, të parët dëshironin autonominë e Shqipërisë, të dytët e kundërshtonin absolutizmin e xhonturqve, të tretët e donin regjimin e vjetër. Prandaj, në kryeqytetet evropiane Shqipëria ishte në qendër të vëmendjes. Ambasadat e Gjermanisë lajmëronin për bisedat e tyre me ministrin e Jashtëm gjerman për Shqipërinë. Nuk besohej dhe as nuk pritej që kryengritja të kishte ndonjë efekt të posaçëm. Por, kryengritja u përhap në të gjitha viset në Kosovë dhe në Shkodër si dhe në vilajetin e Manastirit. Sërish shqiptarët kishin dorëzuar një memorandum të ngjashëm me atë të Greçës ose Librit të Kuq të vitit 1911, por këtë herë qartësisht kërkohej autonomi e plotë për Shqipërinë. Qeveria nuk mundi t'i qëndrojë gjithë këtij presioni dhe më 23 korrik 1912, Sulltani emëroi vezirin e ri, Tefik Mukhtar Pashën, i cili formoi Qeverinë e Re Osmane, në të cilën marrin pjesë disa ministra shqiptarë.

Ghazi Mukhtar Pasha, sipas gjermanëve, kishte javë që po negocionte me udhëheqësit shqiptarë për regjimin e ri që do të lejonte në Shqipëri të mbaheshin armët, por edhe të themelohej një mbrojtje territoriale. Shqipëria, sipas burimeve gjermane, dukej, se vërtetë do të fitonte një autonomi të posaçme, edhe pse kjo fjalë do të anashkalohej.

Më 26 korrik në tërë Kosovën, deri në Kaçanik, shqiptarët përparojnë drejt Shkupit dhe më 12 gusht futen në Shkup. Këtu paraqiten kërkesat e tyre, që njihen si 14 kërkesat e Hasan Prishtinës.

Ndër to veçojmë:

- 1) Njohjen zyrtare të kufijve të Shqipërisë
- 2) Autoritetet civile dhe ushtarake ta kenë kombësinë shqiptare
- 3) Ushtria shqiptare të shërbejë në Shqipëri dhe nga komandantë shqiptarë
- 4) Veprimet zyrtare në Shqipëri të bëhen në gjuhën shqipe.

Vlen të shtohet se shqiptarët kërkonin bashkimin e katër vilajeteve shqiptare në një vilajet autonom. Për shkak të ambicieve të fqinjëve ndaj këtyre territoreve dhe për shkak të kufijve fluidë të këtyre vilajeteve, nga gjermanët shikohej si programim i një konflikti të ri në Ballkan.

Në të njëjtën kohë fqinjët e shqiptarëve shprehën shqetësimin me pretekst se shqiptarët po fitonin shumë dhe në këtë kontekst kërkuan që edhe bashkëkombësit e tyre sllavë dhe grekë t'i fitojnë të njëjtat të drejta.

Më 19 gusht u arrit marrëveshja dhe shqiptarët u kthyen nëpër shtëpitë e tyre. Ambasada Gjermane në Stamboll krahas njoftimeve për përfundimin e kryengritjes dhe largimin e kryengritësve shqiptarë nga Shkupt, jep edhe njoftime të hollësishme për fraksionet shqiptare. Po kështu, përmendet se në gusht të vitit 1912 malazezët kishin pushtuar Beranin por, më vonë, të detyruar nga Fuqitë e Mëdha, qenë tërhoqur nga aty.

Nën ato rrethana, kur Perandoria Osmane po fillonte t'i njihte të drejtat e shqiptarëve dhe t'ua plotësonte kërkesat, qoftë edhe parçiale, monarkitë fqinje ballkanike filluan një luftë propagandistike antishqiptare. Serbët përgatisnin opinionin e vet dhe ndërkombëtar për luftë kundër Perandorisë Osmane, duke u arsyetuar duke se kinëse shqiptarët myslimanë dhe ushtria osmane po e masakronte popullatën jomyslimane. Ata organizojnë një lëvizje protestuese dhe botojnë artikuj të shumtë nëpër gazeta të ndryshme, sidomos në ato ruse. Të njëjtin veprim e marrin edhe malazezët dhe grekët. Këta të fundit protestojnë ashpër për emërimin e një kajmekami shqiptar në Janinë.

Në raporte gjermane mbi autonominë e Shqipërisë trajtohet situata në Shqipëri pas njohjes “de fakto” të autonomisë më 1912. Në Ministrinë e Jashtme të Gjermanisë lajmërohej se në vilajetet shqiptare, shqiptarët kishin marrë në dorë pothuajse qeverisjen. Në një raport nga Stambolli raportohej: “Konsullata Austriake në Mitrovicë po lajmëron me sa vijon: Këtu është themeluar komisioni gjashtëkrerësh, i cili do të ndajë drejtësi dhe do të administrojë dhe do të japë vendime. Nëpër ente të ndryshme janë emëruar nëpunës. Isa Boletini ka lajmëruar krijimin e komisionit të Valiut të Shkupit me komentin se ‘kombi tash e tutje do të vendosë vetë për të ardhmen e vet’. Nga një person që vjen nga Mitrovica mësova se Isa Boletini, i mbështetur nga 6 deri 8 000 veta të armatosur mirë, që një javë është sundimtar i qytetit. Dy divizionet në dhe përreth Mitrovicës qëndrojnë pasive, por kontrollojnë situatën ushtarakisht”.

Për Shqipërinë dhe shqiptarët, në fillim të Luftës së Parë Ballkanike, nga këndvështrimi i diplomatëve gjermanë, në këtë kapitull jepet një vështrim i shkurtër i opinionit diplomatik gjerman. Diplomatët gjermanë shkëmbehen rregullisht mendime, sidomos me austriakët, të cilët në fillim mendonin që Shqipërinë t'ia jepnin nën protektorat Rumanisë por kishte edhe zëra të tjerë që mendonin se administrimi i Shqipërisë duhej t'i jepej një princi që s'i përkiste asnjërës

nga fetë në Shqipëri, pra një protestanti evropian. Ndërkaq Serbia me përkrahje edhe të Rusisë haptazi kërkonte aneksimin e pjesëve veriore të trojeve shqiptare, si plaçkë e luftës. Mirëpo, diplomatët gjermanë ia kishin bërë me dije Qeverisë serbe se një dëshirë e tillë nuk ishte në pajtim me interesat e Fuqive të Mëdha.”

Në raportet diplomatike të konsujve gjermanë trajtohet okupimi i Shqipërisë nga aleanca ballkanike pas fillimit të luftës ballkanike në tetor 1912. Këtu vërehen shqetësimet e Austro-Hungarisë për depërtimin e Serbisë në trojet shqiptare dhe përçarja e Aleancës Trepalëshe mbi këtë çështje. Pasi Italia fillon të lëkundet në këtë çështje dhe duke pasur gjithmonë si cak Vlorën, tërthorazi i jep Serbisë sinjale se është dakord me kërkesën e Serbisë për dalje në Adriatik.

Lidhur me qëndrimin e Gjermanisë për pavarësinë e Shqipërisë fokusi vihet kryesisht mbi qëndrimin e shtetit gjerman për shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë. Vlen të theksohet se gjatë hulumtimit kemi gjetur një dokument unik. Fjala është për një udhëzim të perandorit gjerman Wilhelm I, ku ndërmjet tjerash nënvizohet: “Pasi që disa javë nga ana e Austrisë dhe të Fuqive të Mëdha kërkohet autonomia e Shqipërisë, e cila u bë edhe e domosdoshme, dje Shqipëria ka deklaruar pavarësinë, duke i tërhequr të gjithë nëpunësit turq. Sa të arrijë nga atje kërkesa për njohje, të pranohet ajo në marrëveshje me Vjenën dhe Romën. Me këtë pushon Shqipëria që të jetë pjesë e Turqisë dhe Serbia nuk ka më asnjë arsye ta mbajë të pushtuar ose të aneksojë pjesë të saj. Ajo duhet të tërhiqet menjëherë”. Në këtë dokument flitet edhe për qëndrimet e Fuqive të Mëdha dhe të shteteve përreth mbi Shqipërinë e pavarur dhe kufijtë e mundshëm të saj.

Shtypi gjerman nëpërmjet korrespondentëve të vet në Ballkan, raportonte gati çdo ditë edhe për gjendjen në Shqipëri. Publiku gjerman ishte shumë mirë i informuar se çfarë ndodhte në trojet shqiptare dhe në pjesë tjera të Ballkanit. Duke e parë kontributin e Gjermanisë për pavarësinë e Shqipërisë, vërehet qartë se Gjermania synonte t’i nxirrte në pah interesat e veta në Shqipëri dhe në përgjithësi në Ballkan. Në Gjermani kishte zëra që kërkonin që Gjermania të ndërhynte në çështjen e shqiptarëve në Ballkan, t’i mbrojë interesat e veta ekonomike dhe nëpërmes shqiptarëve të depërtojë në Ballkan. Nga njoftimet e rregullta të diplomatëve gjermanë, mund të kuptohet se Qeveria gjermane kishte njohuri të sakta mbi gjendjen dhe personalitetet shqiptare të kohës, gjithnjë duke e pasur parasysh edhe interesin e saj në këto territore.

Kur dolën propozimet për organizimin e një konference ndërkombëtare për Ballkanin, kryesisht nga Londra dhe ministri i saj i Jashtëm, Grey, ato menjëherë u përkrahën nga Gjermania, e cila nuk dëshironte që, për shkak të Ballkanit, të fillonte një luftë me përmasa evropiane ose botërore



që po e rrezikonte edhe Aleancën Trepalëshe, pasi Italia dhe Austro-Hungaria kishin interesa konfliktuoze në Ballkan, sidomos për Shqipërinë. Po ashtu, Gjermania s' ishte shumë e disponuar të bëhej pjesë e një konflikti të tillë thjesht për interesa të Austro-Hungarisë. Gjermania aty dërgoi një ndër diplomatët e vet më të spikatur të kohës, princin Karl Max Lichinowsky, i cili më vonë botoi edhe një pamflet: "My Mission to London 1912-1914", (Londër, 1918), në të cilin trajton çështjen shqiptare. Në këtë publikim vijnë të përkthyer pjesët mbi Shqipërinë dhe caktimin e kufijve të tij. Princi Lichinowsky në librin e vet shkruan: "Në të gjitha çështjet ne merrnim anën e Austrisë dhe të Italisë për Shqipërinë, portin serb në Adriatik, Shkodrën dhe, po ashtu, edhe për caktimin e kufijve të Shqipërisë." Ndërsa Sir E. Grey, sipas Lichinowsky-t rrallëherë i mbështeste kërkesat e Francës apo të Rusisë. Në këtë publikim të Lichinowsky-t në mënyrë të posaçme trajtohet çështja e Shqipërisë dhe qëndrimi i Gjermanisë ndaj kësaj çështje. Konferenca e Triestes që u organizua në fillim të marsit me iniciativën e mërgatës shqiptare nuk kaloi pa vëmendje edhe të Berlinit. Ndërkohë, politikat gjermane qartësisht ishin rreshtuar pas asaj austriake. Në Trieste, konsulli gjerman kishte ndjekur nga afër konferencën. Prej aty ai lajmëronte në Berlin hollësisht për konferencën. Po ashtu e njoftonte Berlinin edhe me artikuj nga gazetatat e Triestes mbi këtë konferencë. Konferenca që ishte organizuar me financa austro-hungareze u përpoq që:

- 1) Të bënte një vlerësim të situatës se ku ndodhej Shqipëria;
- 2) Të jepte përkrahje të pa kompromis për Qeverinë e Përkohshme të Ismail Qemalit;
- 3) Të merrte rol në zgjedhjen e mbretit të ardhshëm.

Vlen të theksohet se në historiografinë e re shqiptare kjo konferencë ka mbetur në harresë ose nuk është përmendur fare, por duhet theksuar se konferenca ka luajtur rol të rëndësishëm, pasi arriti t' i mbledhë më një vend të gjithë udhëheqësit shqiptarë të kohës duke i dhënë mbështetje të vendosur qeverisë së përkohshme të Ismail Qemalit e cila ishte shumë e dobët dhe deri atëherë s' ishte shumë e qartë se kush e përkrahte dhe kush jo. Pikërisht kjo konferencë tregoi se shumica e shqiptarëve qenë rreshtuar përkrah qeverisë së përkohshme dhe e kishin të qartë se Konferenca e Ambasadorëve në Londër do ta përcaktonte të ardhmen e Shqipërisë.

Synimi ynë me këtë punim disertacioni ka qenë të nxjerrim në pah ngjarjet më relevante të çështjes shqiptare në vitet dramatike në prag të luftërave ballkanike dhe gjatë atyre luftërave, gjithnjë në mbështetje të dokumenteve relevante të proveniencave diplomatike gjermane dhe austro-hungareze. Duke qenë se tema e këtij disertacioni korrespondon drejtpërdrejtë me

qëndrimin e shtetit gjerman ndaj çështjes shqiptare, natyrisht mbështetja kryesore i referohet arkivave dhe bibliotekave gjermane, sidomos Arkivit të Ministrisë së Jashtme të Gjermanisë, Politische Archiv des Auswärtigen Amts (PAAA), dokumentacion ky që korrespondon me vitet e revolucionit nacional shqiptar (1909-1912) deri në shpalljen e Pavarësisë në Vlorë dhe Konferencën e Ambasadorëve në Londër. Përqëndrimi ynë primar ishte elaborimi shkencor i qëndrimit të diplomacisë gjermane në raport me çështjen shqiptare, sidomos në raport me pavarësinë e Shqipërisë. Besojmë se në masë të madhe është arritur ky qëllim sepse nga Arkivi i Ministrisë së Jashtme të Gjermanisë janë nxjerrë mbi një mijë faqe dokumente dhe janë lexuar e konsultuar më shumë se kaq.

Për ta arritur këtë objektiv zhvillova një punë disavjeçare kërkimore-shkencore në Gjermani. Isha në katër etapa në Arkivin e Ministrisë së Jashtme të Gjermanisë, nga ku vjen shumica e lëndës së parë për këtë disertacion. Gjatë punës sime hulumtuese jam konsultuar në vazhdimësi me punonjës të arkivit të cilët gjithmonë kanë qenë të gatshëm dhe të disponueshëm të më ndihmojnë me çdo gjë dhe të më përgjigjen në çdo pyetje duke më dhënë edhe udhëzime se si mund t'i hulumtojë dhe gjejë fondet relevante mbi këtë çështje, që nga konsultat për gjetjen e fondeve e deri tek konsultat për mundësinë e publikimit të dokumenteve të këtij arkivi. Dhe, çfarë është gjithashtu e rëndësishme, hyrja në këtë arkiv është e limituar, por mua për shkaqe teknike, pasi jetoj dhe punoj jashtë Gjermanisë, më është dhënë akses i veçantë. Kështu, pata mundësinë që ta lidh punën time profesionale me punimin e doktoratës, andaj, për këtë i mbetem shumë mirënjohëse stafit të Arkivit të Ministrisë së Jashtme të Gjermanisë në Berlin.

Po ashtu kam ndërmarrë një udhëtim studimor në Bibliotekën dhe Arkivin Kombëtar të Bavarisë (Bayrische Staats Bibliothek, Munchen). Edhe në këtë institucion relevant hulumtova për të gjetur materiale të rëndësishme që korrespondojnë me temën e disertacionit. Megjithatë, më doli se aty nuk kishte fonde për këtë çështje. Ndonëse Bavaria, jo vetëm në kohën e politikanit të njohur konservator Stauss kishte shfaqur interesim të drejtpërdrejt për Shqipërinë dhe shqiptarët, por këtë e kishte bërë edhe gjatë historisë, megjithatë fondet arkivore mbi çështjen e interesimit tonë mungonin. Sidoqoftë, vlenë të theksohet se një ndër studiueset e njohura gjermane të kohës, Marie Amelie Freiin von Godin, për të cilën kam shkruar në tezën time të magistraturës, vinte pikërisht nga Bavaria, Mynihu. Dhe, që në atë kohë kisha lexuar në dorëshkrimet e saj se ajo kishte mbledhur edhe ndihma humanitare për Shqipërinë në vitin 1913 në Mynih, dhe ishte njëra

ndër shoqërueset e familjes Wied, kur erdhi në Shqipëri, por mjerisht në arkiv nuk arrita të zbulojë diçka në lidhje me këtë.

Po ashtu për këtë disertacion të doktoratës zhvillova hulumtim kërkimor-shkencor në Arkivin e Vjenës ku vjela një dokumentacion të pasur diplomatik austro-hungarez mbi çështjet relevante të historisë shqiptare përgjatë viteve 1910-1912. Ky dokumentacion krahasimtar na dëshmon se në vija të përgjithshme dhe relevante, pikëpamjet e diplomatëve gjermanë pajtoheshin me pikëpamjet e diplomatëve austro-hungarezë, në të gjitha krizat shqiptare të viteve 1910, 1911 e 1912, mirëpo kishte raste të rralla të mospajtimit në pikëpamje rreth disa çështjeve, dhe kjo u pa në kohën kur ministri i Jashtëm i Austro-Hungarisë, Berhtold doli me projektin e tij për decentralizim progresiv të krahinave etnike shqiptare në kuadër të Perandorisë Osmane. Po ashtu mund të konkludohet se dokumentacioni diplomatik gjerman e vërteton evoluimin e pikëpamjeve të diplomacisë dhe Qeverisë gjermane ndaj çështjes shqiptare, duke filluar nga kryengritja shqiptare e vitit 1910 kur fillimisht diplomacia gjermane nuk e përkrahu kryengritjen dhe i jipte përkrahje Portës së Lartë për ta shuar atë sa më parë, sepse kishte dyshime në synimet e pansllavizmit rus dhe monarkive sllave ballkanike. Mirëpo, pas masave tejet të vrazhdëta të Portës së Lartë për shuarjen e kryengritjes shqiptare, qëndrimi i diplomacisë gjermane pëson një evoluim të rëndësishëm në favor të çështjes shqiptare dhe nga kjo kohë do të vazhdojë si i tillë deri në njohjen e shtetit shqiptar. Pra, dokumentet diplomatike gjermane dhe austriake që janë shfrytëzuar në këtë punim të doktoratës, dëshmojnë se qeveritë gjermane dhe austro-hungareze në vijimësi ia kishin përkujtuar Portës së Lartë se shqiptarët paraqisnin bastion të fortë kundër pansllavizmit, andaj duhej të trajtoheshin mirë nga Porta.

Një tjetër konkluzion që del nga analiza e hollësishme e dokumentacionit diplomatik gjerman ka të bëjë me tezën se Gjermania ka qenë në përkrahje të Austrisë dhe nuk ka pasur qëllime të veta të drejtpërdrejta në Ballkan. Kjo tezë mund të thuhet se përbën një të vërtetë të pjesëshme, andaj nuk është shkencore që të interpretohet tekstualisht, pasi që Gjermania, ndiqte interesat e veta ekonomike dhe aso kohe ishte në ekspansion gjeoekonomik dhe gjeopolitik në pjesë të ndryshme të globit. Ajo interesohet të përfitonte për ekonominë e saj edhe në këtë pjesë të Evropës, duke e shikuar si një treg të mundshëm profitabil për të ardhmen dhe urëlidhëse me Lindjen. Në të njëjtën kohë, e kishte të qartë se me këtë angazhim duhej t'u viheshin frerë synimeve ekspansioniste ruse në Evropë dhe më gjerë, por njëkohësisht edhe pretendimeve territoriale të monarkive të reja ballkanike mbi trojet etnike shqiptare. Kjo u dëshmuar jo vetëm me rastin e

kryengritjeve shqiptare të viteve 1910, 1911 e sidomos të vitit 1912, por mbi të gjitha me rastin e diskutimit të çështjes së daljes territoriale të Serbisë në det, nëpërmjet Shqipërisë, si dhe çështjes së kufijve të Shqipërisë dhe caktimit të një princi evropian që do të vihej në krye të principatës së re shqiptare. Po ashtu, për herë të parë janë nxjerrë në pah një sërë dokumentesh që mund të jenë me interes për historiografinë shqiptare, si bie fjala, një udhëzim i perandorit të Gjermanisë Vilhelmit II për njohje të menjëhershme të pavarësisë së Shqipërisë dhe për tërheqje të trupave të Serbisë nga Shqipëria më 30 nëntor 1912.

Shumë me interes për trajtimin sa më të gjithanshëm të çështjeve relevante të këtij disertacioni ishin edhe fondet e publikuara që mund të gjenden në Arkivin e Ministrisë së Jashtme të Gjermanisë, në përmbledhjen voluminoze të 40 veprave, të titulluara: Politika e Madhe e Kabineteve Evropiane 1871–1914, Përmbledhje e dokumenteve diplomatike të Ministrisë së Jashtme të Gjermanisë, një publikim i Ministrisë së Jashtme, në Berlin (*Die Grosse Politik der Europaischen Kabinette 1871 -1914, Sammlung der Diplomatischen Akten des Auswaertigen Amtes, Im Auftrag des Auswaertigen Amtes, Berlin*). Këtu, për dallim nga dokumentet që janë përdorur kryesisht në këtë punim, gjenden udhëzime të Ministrisë, të ministrit të Jashtëm dhe të Perandorit të Gjermanisë personalisht, për çështje të veçanta. Dhe, vlenë të theksohet se në disa dokumente të gjetura aty, ministri dhe Perandori vetë kanë bërë shënime me dorë, ku nënvizohet qartazi se ata në çështjen shqiptare përkrahnin aleatin e vet Austro-Hungarinë, pavarësisht politikave të tjera. Këto shënime relevante për herë të parë i ofrohen publikut shqiptar. Ose, bie fjala në një dokument tjetër, ministri i Jashtëm, Kiderlen, qorton shumë rëndë Ambasadorin e Gjermanisë në Konferencën e Londrës, Lichnovsky. Shpresoj shumë, që në një të ardhme të afërt, vëllimet e kësaj periudhe të sillen edhe në Prishtinë në Bibliotekën Kombëtare. Unë personalisht jam duke u interesuar për një gjë të tillë. Edhe për këtë i jam shumë mirënjohëse personelit të Arkivit të Ministrisë së Jashtme të Gjermanisë të cilët me orientuan drejt këtyre dokumenteve, gjatë njërës prej vizitave të mia atje.

Kujtojmë se me këtë disertacion të doktoratës synimi ynë kryesor ishte hulumtimi dhe studimi i lëvizjes kryengritëse shqiptare të viteve 1910-1912 deri në pavarësinë e Shqipërisë dhe duke përfunduar me Konferencën e Triestes, e cila për fat të keq ka mbetur e marginalizuar në historiografinë shqiptare, për një trajtim të merituar shkencor. Ky punim doktorate është pasuruar edhe me disa materiale të tjera koncize mbi caktimin e kufijve të Shqipërisë dhe përmban një sërë dokumentesh arkivore, pasi që Gjermania kishte pasur aty përfaqësuesin e vet. Në një të

ardhme të afërt këto dokumente mund të përmbajnë materiale bazë për një punim tjetër të mundshëm rreth çështjes së caktimit të kufijve të Shqipërisë në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, nga prizmi i diplomacisë gjermane. Në këtë Ministri gjenden mjaftë fonde rreth kësaj teme.

Ky hulumtim dhe studim paraqet një kontribut origjinal në drejtim të rumbullakimit të çështjes së trajtuar, pasi që krahas literaturës relevante janë shqyrtuar burime historike, arkivore nga Arkivi i Ministrisë së Jashtme të Gjermanisë kryesisht të pa publikuara deri më sot. Pra, njoftimet nga arkivat gjermane do të mund të kontribuojnë për plotësimin e mëtejshëm të disa boshllëqeve në historiografinë tonë përkitazi me qëndrimin e Gjermanisë në çështjen shqiptare të vitit 1912, dhe jo vetëm. Llogarisim, që ky punim doktrate mund të jetë ndihmësë jo vetëm për historianët, por edhe për studiuesit e rinj të diplomacisë, të politikës, të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të drejtësisë.

## JETËSHKRIMI I KANDIDATES

Ismije Beshiri ka lindur në Gostivar të Maqedonisë. Shkollën fillore e ka kryer në vendlindje. Gjimnazin e ka kryer në Bremen të Gjermanisë dhe studimet në Ludwig Maximilian Universitet, München të Gjermanisë në Degën e Historisë së Evropës Juglindore. Në të njëjtin institucion ka vijuar studimet e Magjistraturës dhe në vitin 1993 e ka përfunduar dhe mbrojtur me sukses diplomën e tezës së magjistraturës. Gjatë viteve të studimeve (1989-1994), ka punuar si përkthyes, analiste dhe gazetarë për medime të ndryshme gjermane si dhe në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Gjermanisë. Pas studimeve ka punuar një kohë për Institutin Kërkimor të Radios Evropë e Lirë (RFE/RL), në Munih dhe në Pragë, si hulumtuese për Shqipërinë, Maqedoninë dhe Kosovën. Punoi po ashtu si analiste politike në Institutin për Media të Hapura në Pragë të Çekisë. Nga viti 1997 është angazhuar në organizata prestigjioze ndërkombëtare sikurse në OSBE, në Kombet e Bashkuara dhe në Komunitetin Evropian. Ka punuar si Këshilltare Politike në OSBE në Bosnjë dhe Hercegovinë, në zyrën Rajonale në Mostar (1997-1999); Këshilltare Politike e Shefit të Misionit të OSBE-së në Tiranë, Shqipëri (1999-2002); Këshilltare Politike e Shefit të Misionit të OSBE-së në Prishtinë, Kosovë (2002-2007); Këshilltare Politike në Misionin e KB në Prishtinë, Kosovo (UNMIK) (2007-2008); Këshilltare Politike në Misionin e KB në Kabul, Afganistan (UNAMA) (2008); dhe aktualisht Këshilltare Politike dhe Drejtoreshë e Zyrës Politike në EULEX, Prishtinë, Kosovë.

Ismije Beshiri deri më sot ka këto publikime profesionale dhe shkencore:

- Pluralism in Albania, Suedosteuropa Zeitschrift fuer Gegenwartsforschung, No. 10/1991;
- Albanian After the Election, Suedosteuropa ZfG, No. 9/1992;
- Kosovar Independence Lacks International Backing, Transition, 22 March 1996;
- The 2000 elections: the first free and fair elections in Kosovo, Suedosteuropa ZfG, No. 11-12/2000;

- OSCE Mission in Kosovo – Two Years into Institution Building, in: Diplomatiscche Akademie, Wien, 2001;
- Qëndrimi i diplomacisë gjermane ndaj kryengritjeve shqiptare 1910-1912, in The Heritage, Reviste Periodike, Nt 18/2017, ISSN 1857-7482, pp.192-207, Struge 2017.
- Neovisnost Albanije 1912. na temelju njemačke diplomatske dokumentacije, in: Časopis za Suvremenu Povijest, Hrvatski Institut za Povijest, Zagreb. (në botim).

Pjesëmarrja në tubime shkencore:

1993 Shqiptarët e Maqedonisë, Suedost Europa Institute, München, Gjermani

1994 Problemi i Kosovës, Sudost Institut, München, Gjermani

1997 Problemi Shqiptar në Ballkan, Parlameti Gjermani, Bonn, Gjermani

1998 Pavarësia e Shqipërisë, Tiranë, Shqipëri

2000 Kosova dhe Rajoni, Earlyhouse, USA

2002 Pajtimi i shqiptarëve dhe serbëve, Earlyhouse, USA

2005 Shqiptarët dhe Serbët, Project for Ethnic Relations, Luzern, Zvicër dhe Prishtinë – Kosovë